

*përfitimit të ndihmës ekonomike”, ku parashikohet: “Për anëtarin e familjes në nevojë që është person me aftësi të kufizuar, invalid pune nuk llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen”.*

Për sa më sipër, në datën 01.10.2018, Z. G. J. u paraqit pranë Zyrës së Komisionerit dhe paraqiti kërkesën e tij për tërheqje ankese, pasi qëllimi, për të cilin ai e kishte depozituar ankesën e tij ishte arritur dhe tashmë familja e tij ishte pjesë e skemës të 6% bllok ndihmës ekonomike.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 17 dhe nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pikës III/10, të Vendimit nr. 955, datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e proçedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 107, datë 17.07.2018, së Z. G. J., pasi ky i fundit ka depozituar pranë KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës së tij.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

Fusha – te mira e sherbime  
Shkak - “raca”, “gjendja ekonomike”, “gjendja familjare” dhe “aftësia e kufizuar”,